

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**R&O**  
**ME SELI NË TIRANË**

Sot, më date 28.04.2023, në Tiranë,

Z. Nazmi Ogreni, Shtetas Shqiptar, i lindur më datë 15/09/1987 në Korçë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, Leternjoftim ID nr. 036885172 dhe nr. personal I70915066A.

Vendosi të krijojë shoqërinë **R&O**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat si më poshtë:

**NENI 1.**

SHOQËRIA TREGTARE **R&O**, krijohet në formën e Shoqërisë tregtare sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" (në vazhdim Shoqëria).

Kompania është person juridik privat Shqiptar. Zyra e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës.

**NENI 2.**

**Emri i Shoqërisë**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj me emrin tregtar: **R&O shpk.**

**NENI 3.**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike**

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

Tregti me shumicë e produkteve ushqimore, etj..

**NENI 4.**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Violeta Manushi", Pall.70, shk.1, ap.3, Tiranë.

**NENI 5.**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut të vetëm, z. Nazmi Ogreni, në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Kontributi i Ortakut të vetëm në kapitalin themeltar është 1 kuotë, me vlerë 10.000 lekë, zotëron 100% të kapitalit.



**NENI 6.**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kompania ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

**NENI 7.**  
**Organet drejtuese**

Referuar ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë krijohen si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Forma dhe rregullat e organizimit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

Shoqëria fillimisht administrohet nga një Administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për 5 vjet, i rinovueshëm, përveç rasteve kur revokohet ose jep dorëheqjen, ose për arsye të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë, do të jetë z. Nazmi Ogreni, shtetas Shqiptar, i lindur më 15/09/1987, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. personal I70915066A.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, gjithashtu në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto kompetenca në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi. Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm, edhe jo ortak, ose nga disa administatore edhe jo ortakë, sipas asaj që është përcaktuar në momentin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë u është besuar disa personave, vendimi i emërimit përcakton në mënyrë alternative:


- a) nëse administratorët do të funksionojnë në mënyrë kolegjiale, duke formuar kështu këshillin e administrimit;
- b) nëse administrimi i është caktuar veçmas apo bashkërisht.

**NENI 8.**

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, hapja e zyrave apo degëve dytësore do të bëhet në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe të Statutit.

**NENI 9.**

Punonjësit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë janë përgjegjës dhe duhet të kompensojnë kompaninë për dëmet e shkaktuara me dashje për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.



**NENI 10.**  
**Ligji në fuqi**

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga rregullat e statutit të nënshkruar nga anëtarët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 11.**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e shoqërisë do të zgjidhet nga ortaket në të kundërt mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

**NENI 12.**  
**Dispozitat përfundimtare**

Akti i themelimit hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga anëtari përbërës, u konstatua në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje.

**ORTAKU THEMELUES**

**NAZMI OGRENI**

Nazm. Ogreni 